



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME



Npi – 01/223 datë: 15.07.2022

LISTA E KËRKESAVE
Për Kuvendin e Komunës më: XX.08.2022

1. z.Meriton Baftiu nga fshati Davidoc, Rr."Baftiu" Nr.10, Kërkesa Nr.01-070/05-6193/19 datë: 04.03.2019, i cili në emër të familjes Baftiu, dhe propozimeve të subjekteve sportive si:

1. Federata e Hendbollit të Kosovës,
2. Federata e Sportit Shkollor të Kosovës,
3. Klubi hendbollistik "Vjosa" – Shtime,
4. Klubi hendbollistik KH "Kastrioti" – Ferizaj,
5. Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Shkollore – Ferizaj.

Ka kërkuar, nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, emërtimin e Palestrës së re Sportive në Shtime me emrin e sportistit të mirënjohur "Haki Baftiu".

Arsyetim: Haki Baftiu u lind më 10 shtator 1946, në fshatin Davidoc, Komuna e Shtimes. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, normalen në Ferizaj ndërsa Shkollën e Lartë të Edukatës Fizike e përfundoi në vitet 1973/1974. Që nga viti 1968 punoi si arsimtar i Edukatës Fizike në shkollën "Emin Duraku" në Shtime.

Mbi 38 vite punoi ku dha kontribut të vazhdueshëm në lëmin e sportit në Komunën e Shtimes.

Me Haki Baftiun në krye, në Komunën e Shtimes u aktivizua edhe shkolla e hendbollit në vitin 1993, ku brezat e ri nisen të mësojnë hapat e parë ndërsa kulmin e suksesit e arritën kur kjo shkollë në vitin 1995 u shpall si më e mira në Kosovë nga federata e hendbollit të Kosovës. Haki Baftiu tregoi rezultate të mira me Klubin Hendboll "Vjosa" në vitin 1993, ku e fitoi Kupën e Kosovës.

Mirënjohjet për punën dhe angazhimin e tij në sport janë të shumta, në vitet 1995, 1997 dhe 2001, ai u zgjodh trajneri më i mirë i vitit nga Federata e Hendbollit të Kosovës.

83. KONKLuzion 1 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-6193-19 të Meriton Baftiu –Davidoc.

125. KONKLuzion 2 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-6193-19 të Meriton Baftiu –Davidoc

155. KONKLuzion 3 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-6193-19 të Meriton Baftiu –Davidoc

194. KONKLuzion 4 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-6193-19 të Meriton Baftiu –Davidoc

222. KONKLuzion 5 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-6193-19 të Meriton Baftiu –Davidoc

256. KONKLuzion 6 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-6193-19 të Meriton Baftiu –Davidoc

323. KONKLuzion 7 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-6193-19 të Meriton Baftiu –Davidoc

361. KONKLuzion 8 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-6193-19 të Meriton Baftiu -Davidoc

143. KONKLuzion 9 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-6193-19 të Meriton Baftiu -Davidoc më 31.05.2022

2. znj.Demrije Salihaj, Kryetare e OVL-së të UÇK-së Shtime, Kërkesa Nr.01-70/05-9856/19 datë: 11.04.2019, e cila në emër të tri Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së (OVL, SHIL dhe SHFD) ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, që lidhur me emërtimin e objekteve publike me rëndësi shoqërore siç janë: 1.Palestra Sportive, 2.Stadiumi i Futbollit, 3. Shtëpia e Kulturës, dhe 4. Qendra Rinore (objekti i vjetër) Të tri Shoqatat kemi mbajtur mbledhje të përbashkët dhe kemi dalë me propozimet konkrete për emërtim, e këtyre objekteve, me arsyetimet e dhëna, të bazuara në fakte, për secilin rast veç e veç.

Propozimi 1. Palestra Sportive, Propozoj të emërohet me emrin e Heroit "Skender Zeqir Salihaj".

Propozimi 2. Stadiumi Futbollit, Propozojmë të emërtohet me emrin e dëshmorit "Rahman Tafa".

Propozimi 3. Shtëpia e Kulturës, Propozojmë të emërtohet me emrin "Dëshmorët e Raçakut".

Propozimi 4. Qendra Rinore, Propozojmë që të emërtohet me emrin e dëshmorit "Ruzhdi Salihu".

126. KONKLuzion 1 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-9856-19 të Demrije Salihaj –Mollopolc.

156. KONKLuzion 2 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-9856-19 të Demrije Salihaj –Mollopolc

195. KONKLuzion 3 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-9856-19 të Demrije Salihaj –Mollopolc

223. KONKLuzion 4 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-9856-19 të Demrije Salihaj –Mollopolc

257. KONKLuzion 5 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-9856-19 të Demrije Salihaj –Mollopolc

324. KONKLuzion 6 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-9856-19 të Demrije Salihaj –Mollopolc

362. KONKLuzion 7 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-9856-19 të Demrije Salihaj -Mollopolc
144. KONKLuzion 8 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-9856-19 të Demrije Salihaj -Mollopolc më 31.05.2022

3. z.Ramiz Smajli, Sekretar i Klubit “Kik Boks-Karate Klub” Shtime, Kërkesa Nr.01-70/05-9914/19 datë: 11.04.2019, i cili në emër të tri Klubeve Sportive në Shtime (Klubi i Boksit, Klubi i Karatesë dhe Klubi i Kik-Boksit) kanë propozuar që Palestra Sportive të emërtohet me emrin e Heroit “Skender Zeqir Salihaj”.

127. KONKLuzion 1 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-9914-19 të Ramiz Smajli -Mollopolc
157. KONKLuzion 2 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-9914-19 të Ramiz Smajli -Mollopolc
196. KONKLuzion 3 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-9914-19 të Ramiz Smajli -Mollopolc
224. KONKLuzion 4 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-9914-19 të Ramiz Smajli -Mollopolc
258. KONKLuzion 5 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-9914-19 të Ramiz Smajli -Mollopolc
325. KONKLuzion 6 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-9914-19 të Ramiz Smajli -Mollopolc
363. KONKLuzion 7 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-9914-19 të Ramiz Smajli -Mollopolc
145. KONKLuzion 8 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-9914-19 të Ramiz Smajli -Mollopolc më 31.05.2022

4. z.Adem Salihaj nga fshati Mollopolc, Kërkesa Nr.01-070/05-0010324/19 datë:17/04/2019 i cili në emër të familjes së Heroit të Kosovës “Skënder Salihaj”, ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, emërtimin e Palestrës së re Sportive në Shtime me emrin e Heroit “Skënder Salihaj”.

158. KONKLuzion 1 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-10324-19 të Adem Salihaj- Mollopolc.
197. KONKLuzion 2 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-10324-19 të Adem Salihaj- Mollopolc
225. KONKLuzion 3 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-10324-19 të Adem Salihaj- Mollopolc
259. KONKLuzion 4 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-10324-19 të Adem Salihaj- Mollopolc
326. KONKLuzion 5 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-10324-19 të Adem Salihaj- Mollopolc
364. KONKLuzion 6 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-10324-19 të Adem Salihaj- Mollopolc
146. KONKLuzion 7 - për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-10324-19 të Adem Salihaj- Mollopolc më 31.05.2022

5. z.Zenel Shabani nga fshati Godanc i poshtëm, Kërkesa Nr.01-070/05-31837/19 datë:14/11/2019 i cili në emër të familjes Gashi nga Godanci i poshtëm, ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes që Stadioni i futbollit në Shtime të emërtohet me emrin e futbollistit të ndjerë “Qerim Gashi”. Kërkesën tonë e arsyetojmë si vijon: Familja e Qerim Gashit ka qenë gjithëherë familje sportive, dhe kemi marrë pjesë gjithmonë në organizimin dhe shtytjen përpara të proceseve sportive. Familjari jonë tani i ndjerë Qerim Gashi, i lindur në Godanc të Poshtëm më 22.11.1970 që nga mosha e hershme e rinisë ka qenë lojtarë dhe pjesëmarrës i jetës sportive të K.F –“VJOSA” që nga viti 1990-2008 deri sa u nda nga jeta në moshë shumë të re. Kontributi i tij në rrugëtimin e K.F –“VJOSA” është i pa zëvendësueshëm sepse ka qenë lojtar kyç në këtë klub. Qerim Gashi ishte reprezentues i Shtimes në futbollin Kosovar. Qerimi ka qenë hallka kryesore e rrugëtimin të K.F –“VJOSA” që nga fillimi deri në pavarësimin e sportit Shtimjan nga strukturat Serbe më 1991 deri në çlirimin e Kosovës. Tërë organizimi dhe pjesëmarrja në garat e K.F –“VJOSA” në futbollin Kosovar ka qenë e lidhur dhe e koordinuar me fshatin Godanc, dhe me familjen e Qerim Gashit. Futbolli Shtimjan në këtë periudhë kishte mbetur në mjegull të plotë, ishin të rinjtë e fshatit Godanc me Qerim Gashin në krye që e murrën përsipër barrën për udhëheqjen dhe organizimin e sportit dhe futbollit në veçanti të komunës së Shtimes, këtë e dëshmojnë procesverbalet e paraluftës të Lidhjes së Sporteve të komunës së Shtimes. Kështu që në këtë periudhë shumë të vështirë, kontributi i Qerimit ishte i pakontestueshëm.

147. KONKLuzion - 1 për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-31837-19 të Adem Salihaj- Mollopolc më 31.05.2022

6. znj.Lumturi Hysaj – Shtime, Kërkesa Nr.01-070/05-4831/20 datë:24.02.2020, e cila në emër të familjes Hysaj nga Shtimja ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, emërtimin e Shtëpisë së Kulturës me emrin e Aktorit të ndjerë “Fahri Hysaj” kërkesa është përcjellë me një peticion të vërtetuar me nënshkrimet e 552 banorëve të komunës së Shtimes. Pjesë e arsyetimit për këtë emërtim të propozuar është dhënë nga familjarët si vijon: Fahri Hysaj ishte profesor në universitetin e Prishtinës, Univerzitetin e Tetovës, Akademinë e Arteve në Tiranë, Regjisor i programeve artistike dhe dokumentare në Radio Televizionin e Prishtinës. Ka punuar mbi 12 vepra të spikatura artistike ndër to: “Zogjët më nuk vinë këtu”, “E shtëna në borë”, “Fëtyra dheu” , “Kaqqarrel”, “Gjurmët e humbura” për heroin Agim Ramadani, etj.

148. KONKLuzion - 1 për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-4831-20 të Lumturie Hysaj – Shtime, më 31.05.2022

7. z.Vehap Ahmeti – Shtime, Kërkesa Nr.01-070/05-5541/20 datë:03.03.2020, i cili në emër të Këshillit Organizativ për emërtimin e objekteve publike, në përbërjen prej 1. Vehap Ahmeti – Shtime, 2.Nazmi Ramadani – Godanc i epërm, 3. Mehdi Shaqiri – Shtime, kanë kërkuar me petition prej 104 fletëve, me 1616 nënshkrime të banorëve të komunës së Shtimes, që të bëhen këto emërtime si vijon:

1. SH.M.L Profesionale në Shtime të emërtohet “Jetë Hasani & Ruzhdi Salihu”.
2. SH.M.U. “Bajram Curri” në Petrovë të riemërtohet “Tre Dëshmorët e Petrovës” (Xhemshir Xhemshiri, Fadil Rashiti dhe Kadri Ademaj).
3. SH.M.U. “Emin Duraku” në Belinc të riemërtohet “Afrim Musliu”.
4. Vendorsjen e Shtatores të veprimtarit të çështjes Kombëtare Ahmet Shtimja, në sheshin “Ahmet Shtimja”.
5. Ndarja e lokacionit dhe vendosja e shtatoreve të Dëshmorëve të UÇK-së, Jetë Hasani, Afrim Musliu, dhe Ruzhdi Salihu, në mes të rreth-rrotullimit të udhëkryqi, Shtime-Belinc-Zborc-Raçak.

149. KONKLuzion – 1 për shtyrjen e kër. Nr.01-70-05-5541-20 të Vehap Ahmeti – Shtime, më 31.05.2022

8. z.Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, i përfaqësuar nga Avokati z.Kemajl Ademaj me zyrën e Avokatisë në Ferizaj Rr.”Hamëz Jashari” p.n. Kërkesa Nr.01-070/05-19162/20 datë:24.09.2020, i cili në emër të z.Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, që të ndryshohet vendimi i Kuvendit Npi-01/179 datë:31.08.2020 për këmbimin e pronës Komunale, me të cilin kërkon që në këmbimin e pronave që duhet të përfshihen përveç Ngastrave Nr.724-0 me sipërfaqe 170m² si dhe Nr.729-0 me sipërfaqe 617m² Z.K-Petrovë, që janë të potencuar në vendim, kërkoj që në vendim për këmbim të përfshihet edhe Ngastra Kadastrale Nr.726-0 me sipërfaqe prej 270m². Evidentuar pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime.

241. VENDIM për anulimin e Vend. të Npi-01-179 të Bahri Rexhaj -Petrovë sipas MAPL

244. KONKLuzion për shtyrjen e kër. Nr.01-070-05-19162-20 të Bahri Rexhaj – Petrovë

150. KONKLuzion - 2 për shtyrjen e kërkesës Nr.19162-20 të Bahri Rexhaj – Petrovë, më 31.05.2022

9. z.Bekim Osmani – Raçak, Kërkesa Nr.01-070/05-19428/20 datë:29.09.2020, i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, në emër të familjes Osmani ka kërkuar, shpronësimin e pronave në vendin ku janë nxënë pengjet e shumicës së të masakruarve në Raçak në shtëpinë tash më të njohur të Sadik Osmanit. Kërkoj nga Kuvendi që të bëhet një zgjidhje për shpronësimin e pronave tona që janë paraparë të futen në listën e trashëgimisë për ruajtjen e gjurmëve të Masakrës së Raçakut më 15 Janar 1999. (Nuk ka fletë poseduese dhe nuk është përmendur sasia e tokës që duhet shpronësuar)

245. KONKLuzion për shtyrjen e kër. Nr.01-070-05-19428-20 të Bekim Osmani – Raçak

151. KONKLuzion - 2 për shtyrjen e kërkesës Nr.19428-20 të Bekim Osmani – Raçak, më 31.05.2022

10. Violeta Hysenaj - Rr. “Ymer Prizreni” Nr.152 Shtime, Kërkesa Nr.01-070/05-23097/21 datë:03.09.2021, e cila nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, ka kërkuar që rruga e cila gjendet te toka e ashtuquajtur batllak, kam dëshirë që të emërtohet me emrin e babës timë “Emrush Hysenaj”.

152. KONKLuzion - 1 për shtyrjen e kërkesës Nr.23097-21 të Violeta Hysenaj Shtime, më 31.05.2022

11.z.Naim Baftiu – Rr.”Smail Gorani” Nr.23 Davidovc, Kërkesa Nr.01-070/05-5211/22 datë:23.02.2022, i cili në emër të Kryetarit të fshatit Ilmi Sadriu, Rr.”Sadriu” Nr.38 – Davidovc, ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes:

1. Lirimin e të gjitha pronave publike në fshatin Davidovc, të uzurpuara nga uzurpatorët recitivistë, e që kanë qenë të ditura edhe nga ish Kryetari i Komunës, si dhe nga ish legjislaturat e mandateve të kaluara të Kuvendit të Komunës së Shtimes.
2. ANULIMIN e 5 vendimeve të Kuvendit të Komunës së Shtimes të datës: 03.06.2022, si vijon:
 - a. VENDIM për dhënjën në Shfrytëzim 6700 m² Tokë firmës 'AUTOCENTER A Grup' Davidovc me numër: Npi-01/141 dt.03.06.2021.

- b. VENDIM për dhënjën në Shfrytëzim 6900 m² Tokë firmës 'LONI PERGOLA' Shtime, me numër: Npi-01/142 dt.03.06.2021.
- c. VENDIM për dhënjën në Shfrytëzim 2928,66 m² Tokë firmës 'GAJREPI' Shtime, me numër: Npi-01/143 dt.03.06.2021.
- d. VENDIM për dhënjën në Shfrytëzim 2728,66 m² Tokë firmës 'FIDANI PLAST' Shtime me numër: Npi-01/144 dt.03.06.2021.
- e. VENDIM për dhënjën në Shfrytëzim 2728,66 m² Tokë firmës 'DIZAJNI' Shtime, me numër: Npi-01/145 dt.03.06.2021.

A r s y e t i m: Kryesia e Fshatit Davidovc në mbledhjen e mbajtur më 18.02.2022, ka diskutuar gjatë lidhur me këto që u cekën më lartë, dhe ka ardhur në përfundim se: Kryetari dhe Legjislatura e kaluar e Kuvendit, fshatin tonë e ka anashkaluar, ku mund të përmenden si investime vetëm 5 projekte të vogla siç janë: 2 Km. Rrugë të asfaltuar të fshatit, 3 pengesa (police të shtrirë) në rrugën kryesore, 800m. rrugë fushore me zhavor, 2.5Km. kanale fushore të hapura, dhe një ndriqim publik i përgjysmuar. Nuk janë marrë fare parasysh peticionet që i kemi bërë në vitin 2008 me 308 nënshkrime, për mbrojtjen e pronës publike të fshatit, ka pasë protestë mbi 70 pjesëmarrës të fshatit duke kundërshtuar tjetërsimin dhe uzurpimin e pronës publike të fshatit Davidovc, (dëshmi: Aktvendimi i Gjykatës Komonale, për lirin e të akuzuarve si të pafajshëm, shifra:0199 RI.Nr.8623-26-08 i dt.17.11.2008). Komuniteti i fshatit Davidovc nuk është pyetur fare për aprovimin e Vendimeve (a - e) nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, e që ne konsiderojmë se sipas Ligjit është dashur të ketë diskutim publik me banorët e fshatit. Më pastaj Kryesia e fshatit Konstaton se janë shkelur: 1. Neni 52 pika 2 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 2. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, 3. Ligji për mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233, 4. Ligji për mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, 5. Ligji për parandalimin dhe kontrollimin e integruar të mjedisit Nr.03/L-043, si dhe 6. Ligji për planifikimin hapësinor Nr.04-L-174. Për këtë arsye ne kërkojmë lirin e pronave të uzurpuara të fshatit si dhe anulimin e 5 vendimeve të Kuvendit të cekura më lartë. (për më shumë shih kërkesën e skanuar).

153. KONKLuzion - 1 për shtyrjen e kërkesës Nr.5211-22 të Naim Baftiu – Davidovc, më 31.05.2022

12. z.Nazmi Seferi – Shtime, Kërkesa Nr.01-070/05-10741/22 datë: 29.04.2022, i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, ka kërkuar siç ka thënë ai, emërtimin e një rruge që lidhet me rrugën kryesore “Anton Çeta” në Shtime. Arsye për këtë është se po kemi probleme me Postë dhe shumë gjëra të tjera.

155. KONKLuzion - 1 për shtyrjen e kërkesës Nr.10741-22 të Nazmi Seferi, Shtime, më 31.05.2022

13. “SPIN” – TV, përfaqësuesi z.Ramadan Ahmeti – Shtime, Kërkesa Nr.01-070/05-16653/22 datë: 28.06.2022, i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, ka kërkuar siç ka thënë ai bashkëpunim të ndërsjellë për transmetimin e seancave të Kuvendit si dhe aktivitetet e sajë përmes televizionit “SPIN” TV – Shtime, në rrjetet sociale You-Tube, Facebook, etj. Titulli i Projektit: “Mbështetje financiare nga Kuvendi i Komunal” Shtime, në shumën totale 30.000€ për periudhën një vjeqare Qershor 2022-Qershor 2023.

14. z.Agim Imeri – Shtime, Kërkesa Nr.01-070/05-16906/22 datë: 29.06.2022, i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, ka kërkuar që të emërtohet ndonjë rrugë në komunën e Shtimes me emrin “Muharrem Imeri” me arsyetimin se Muharrem Imeri nga Shtimja, i lindur në Shtime (1926-2017) ishte Kryetar i Këshillit të Komunës së Shtimes në vitin 1957-1960, si dhe përfaqësues në Kuvendin e atëhershëm, pastaj nënkryetar i Këshillit Komunal në Ferizaj. Veprimtar për emancipimin dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të Shtimes e më gjerë. U pensionua si Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në vitin 1986. Emërtimi i një rruge i bën nder të gjithëve pa dallim.

15. z.Lumni Rashiti - Petrovë, Kërkesa Nr.01-070/05-17063/22 datë: 30.06.2022, i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, ka kërkuar kompenzimin e dëmit për vërshimet që kanë ndodhur më 08.08.2020 dhe i kanë shkaktuar dëm në shtëpinë e banimit. Kërkesës ja bashkangjes edhe Formularin për vlerësimin

e dëmeve në teren më 10.08.2020 ku është vlerësuar se kam pas dëme në shumën prej 6480€. Kam gjendjen e vështirë ekonomike, jemi 7 anëtarë të familjes ku jetoj me 170€ të pensionit të Veteranit. Nëse nuk më ipet kompensimi që më takon me ligj unë do të ankojem dikund tjetër.

16. Kompania "KASTRIOTI" O.P përfaqësuesi z.Kastriot Fazlija – Carralevë, Kërkesa Nr.01-070/05-17731/22 datë: 06.07.2022, i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, ka kërkuar Pëlqim për përdorimin e rrugës ekzistuese (transferimin ose uljen e sajë në nivel të barabart me sipërfaqen e shfrytëzuar gurore), që nënkupton nxjerrjen dhe shfrytëzimin e gurit në këtë rrugë. Numri i parcelës është Nr.01141-0, Zona Kadastrale-Carralevë, Evidentuar "Pasuri Shoqërore, rrugë të pakategorizuara" e cila gjendet në mes të parcelave tona, specifikisht në mes N.K-01140-0 dhe 01142-0. Kompania jonë merr përgjegjësi për ç'do plan të rrugëve që do të nxjerrë Kuvendi në këto parcela që ti ndërtojë ato sipas nevojës dhe po ashtu merr përgjegjësi që rruga aty të jetë gjithmonë funksionale. Ju bëjmë me dije se ne jemi duke zhvilluar veprimtarinë tonë në parcelat që kemi lejen, por që kjo rrugë në mes të parcelave ku ne po punojmë po na shkakton telashe shumë të mëdha.

17. z.Hasan Hyseni – Carralevë, Kërkesa Nr.01-070/05-18822/22 datë: 15.07.2022, i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, ka kërkuar ndarjen e një Trualli prej 3 Ari, te Tregu i gjelbërt në Shtime. Meqenëse jam në kushte të vështira ekonomike me 5 anëtarë të familjes, me vetem një rrogë prej 250€, si dhe duke marrë parasysh faktin se jam në një bashkpunim të ngushtë me OJQ-në "Jetimat e Ballkanit" të cilët më kanë premtuar ndërtimin e një shtëpie banimi por me kusht që të siguroj një truall, unë po i drejtohem Kuvendit që mundësisht të mi ndajë 3 ari truall për ta ndërtuar një shtëpi për familjen time.

18. z.Musa Shabani (Kryetari i fshatit) – Vojnovc, Kërkesa Nr.01-070/05-19493/22 datë: 20.07.2022, i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, në emër të Këshillit të fshatit Vojnovc ka kërkuar leje për vendosjen e një Lapidari, te vendalja e Autobusit në fshatin Vojnovc. Lokacioni është evidentuar (P.SH.RRUGË) Pronë Shoqërore e Rrugëve. Numri i Ngatrës Kadastrale P-72809015-00913-1, Zona Kadastrale – Vojnovc.

19. z.Hysen Abazi, Godanc i epërm, (Lagja e Cenëve) Kërkesa Nr.01-070/05-22221/22 datë: 08.08.2022, i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, ka kërkuar që të ndryshohet emërtimi i rrugës "Arsim Zeqiri" në Godanc të epërm me arsyetimin se: Duke pas parasysh se emërtimet e rrugëve lidhen zakonisht me ndonjë figurë apo personalitet që e karakterizon atë lagje, dhe meqenëse kjo rrugë e përshkon lagjen tonë të Cenëve, ne si banorë të kësaj lagje jemi pajtuar unanimisht (me nënshkrime) që të kërkojmë nga Kuvendi i Komunës së Shtimes ndryshimin e emërtimit të rrugës "Arsim Zeqiri" me emrin "Cenë Meha".

20. z.Avdullah Musliu, Raqak Kërkesa Nr.01-070/05-24330/22 datë: 22.08.2022, i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, ka kërkuar që në projekt buxhetin Komunal të ndajë një buxhet për mirëmbajtjen e monumentve "Kulla e Lirisë" dhe "Shkronjat e UÇK-së". Gjithashtu kërkojë që edhe rruga që është hapur nga "Kompleksi Memorial i Reqakut" deri te "Kulla e Lirisë" me gjatësi 1500 (një mijë e pesqindë metra), i mungon asfaltimi edhe po thuajse është e pakalueshme për shkak të dëmtimit nga shiu.

Arsyetim; Që nga koha kur është ndërtuar "Kulla e Lirisë" e në veqanti kur janë vendosur "Shkronjat e UÇK-së" në këtë vitë, janë bërë shumë të vizituara nga qytetarët e gjitha trevave të Kosovës e më gjerë.

Mbesë me shpres se kjo kërkeë do të mirret parasyshë nga ju të nderuar përfaqësues të popullit nga Komuna Shtimes.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Adem